



**Republika e Kosovës – Republika Kosova**  
**Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa**  
**Izborni Panel za Žalbe i Predstavke**

**Anr. 284/2014**

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP), i përbërë nga gjyqtarët: Muhamet Rexha kryesues, Ferit Osmani dhe Rafet Haxhaj anëtarë, duke vendosur përkitazi me ankesën e Lëvizja Vetëvendosje (LVV) dega në Malishevë, paraqitur kundër subjektit politik Nisma për Kosovë dega në Malishevë, për shkak të parregullsive gjatë ditës së zgjedhjeve, për Zgjedhjet e Parakohshme për Kuvendin e Republikës së Kosovës, në seancën e panelit të mbajtur me dt. 12.06.2014, mori këtë:

### **VENDIM**

**Refuzohet** si e pabazuar ankesa e Lëvizja Vetëvendosje (LVV) dega në Malishevë

### **Arsyetim**

PZAP-i, më datë 09.06.2014 ka pranuar një ankesë nga LVV dega në Malishevë, me të cilën pretendohet se me datën 8 qershor 2014 rreth orës 16:25 në QV 3036A/02R në fshatin Carallukë komisionari i LVV-së në këtë vendvotim ka paraqitur shkeljen për shpalesje të votës gjatë hedhjes në kutinë e votimit nga Shefket hoti ku komisionari Izet Hoti komisioner rezerva nga subjekti politik Nisma për Kosovë e ka detyruar që ta bëjë një gjë të tillë duke një gjë të tillë dhe duke i thënë votuesit “hajde ta bëjmë një foto bashk para se ta hedhësh votën në kutinë e votimit me qëllim që votuesi në këtë mënyrë për ti treguar se kë kishte votuar duke e shpalesur votën. Sipas parashtruesit të ankesës është parregullsi komisionari i LVV-se e Liman Berisha e ka shënuar në librin e vërejtjeve, ku për këtë është kërcënuar nga komisionari rezervë i Nismas Izet Hoti drejtuar ndaj Liman Berishës se nëse ja shkruan emrin në librin e vërejtjeve ai nuk do të mund të jetojë më në fshatin Carallukë., Këto veprime sipas parashtruesit të ankesës janë në kundërshtim me dispozitat ligjore të LVP-së

Lidhur me këtë çështje PZAP-i e informoi Policinë e Kosovës dhe kërkoi informata më të hollësishme për këtë rast.

Në raportin e policisë të Kosovës theksohet se ankesa është pranuar nga Prokurori i shtetit dhe se lidhur me ankesën stacioni policor nuk është njoftuar për masat e ndërruara nga prokurori.

PZAP-i kërkoi nga KQZ materialin zgjedhor konkretisht kërkoi Librin e vërejtjeve për atë vendvotim, ku KQZ-ja dorëzoi në PZAP materialin e kërkuar, ku nga shqyrtimi i

këtij materiali konkretisht nga shiqimi në librin e vërejtjeve për verifikimin e ndonje parregullsie të evidentuar gjeti a aty nuk kishte asnjë lloj vërejtje të shënuar nga askush dhe as nga komisionari i LVV-së Liman Berisha ashtu siç pretendonte pala ankuese në ankesën e saj.

Lidhur me ankesën në fjalë PZAP-i e informoi edhe subjektin politik Nisma për Kosovë dhe kërkoi përgjigjen në fjalë për ankesën e parashtruar. Në përgjigjen në ankesë subjekti politik Nisma për Kosovë në mënyrë kategorike i mohon pretendimet e tilla ankimore duke i konsideruar si improvizime veprimet e parashtruesi i ankesës pasi që nuk ka ndonjë dëshmi dhe prova relevante me atë çka thuhet në ankesë.

PZAP-i, pasi që shqyrtoi dhe analizoi shkresat e lëndës gjeti se:

### **ankesa është e pabazuar**

PZAP-i ka gjetur se pretendimet e tilla janë të pa bazuar pasi që PZAP-i nga të gjitha veprimet e ndërmarra hetimore në bashkëpunim me institucionet tjera përgjegjëse për procesin zgjedhor nuk ka arritur që të vërtetohen pretendimet e parashtruara me ankesë pasi që edhe pas shqyrtimit dhe verifikimit të librit të vërejtjeve PZAP-i nuk ka gjetur se ka pasur ndonjë vërejtje të shënuar nga komisionari i LVV-së Liman Berisha, si dhe as nga raporti i policisë së Kosovës e cila gjatë ditës së zgjedhjeve ka qenë atje nuk është raportuar për ndonjë parregullsi lidhur me rastin në fjalë. Andaj mbi këtë bazë PZAP-i vlerëson se ankesa në fjalë është pa bazë, dhe në kuptim të nenit 118 paragrafi 1 të LZP-së, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

### **Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia**

Anr. 284/2014 më datën 12.06.2014

**Kryesuesi i Panelit**  
**Muftamet Rexha**



#### ***Udhëzim Juridik:***

PZAP nuk do t'i pranojë kërkesat për ri-apelim, sepse vendimet e tij do të konsiderohen si përfundimtare. Prandaj, siç parashihet në Nenin 118.4 të LZP-së, *ankesa në Gjykatën Supreme të Kosovës mund të paraqitet brenda njëzetekatër (24) orëve nga momenti i marrjes së vendimit nga PZAP-i, në rast se gjoba e përfshirë është më e lartë sesa pesëmijë (5, 000) Euro ose në rast se çështja prek një të drejtë themelore.*